

✓
Prot. 7203

D. 18.12.2020

ALBPETROL sh.a
Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019
Së bashku me Raportin e Audituesit të Pavarur

Përmbajtja

Raporti i Audituesve të Pavarur.....	5
Pasqyra e Pozicionit Financiar.....	10
Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave Gjithpërfshirëse.....	11
Pasqyra e Ndryshimeve në Kapitalin Neto.....	12
Pasqyra e Flukseve të Mjeteve Monetare.....	13
Shënimet Shpjeguese.....	14
1. Informacion i përgjithshëm.....	14
2. Bazat e përgatitjes.....	15
2.1. Deklarata e pajtueshmërisë.....	15
2.2. Baza e matjes.....	15
2.3. Parimi i vijimësisë.....	16
2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes.....	16
2.5. Vlerësime dhe gjykime.....	16
2.5.1 Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme.....	16
2.5.2 Provizionet.....	17
2.5.3 Zhvlerësimi i inventarëve.....	17
3. Standarde dhe interpretime të reja.....	17
3.1. Standardet e reja dhe të rishikuara të cilat janë në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019.....	17
3.2. Standardet e reja, ndryshimet në standardet ekzistuese dhe interpretimet e reja të publikuara, por që ende nuk janë efektive.....	18
4. Politikat Kontabël.....	18
4.1. Transaksionet në monedhë të huaj.....	18
4.2. Instrumentat financiarë.....	19
4.2.1 Njohja dhe çrregjistrimi.....	19
4.2.2 Klasifikimi dhe matja fillestare e aktiveve financiare.....	19
4.2.3 Matja e mëpasshme e aktiveve financiare.....	20
4.2.4 Zhvlerësimi i aktiveve financiare.....	20
4.2.5 Instrumentet financiare derivative dhe kontabiliteti mbrojtës.....	21
4.2.6 Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre.....	22
4.2.7 Llogari të arkëtueshme.....	22
4.2.8 Llogari të pagueshme.....	23
4.2.9 Hua të marra dhe të dhëna.....	23

4.2.10 Inventaret.....	23
4.2.11 Aktive afatgjata materiale.....	24
4.2.12 Aktive afatgjata jomateriale.....	25
4.2.13 Të ardhurat.....	26
4.2.14 Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit.....	26
4.2.15 Qiratë.....	27
4.2.16 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare.....	27
4.2.17 Tatimi mbi fitimin.....	27
4.2.18 Përfitimet e punonjësve.....	27
4.2.19 Provizionet.....	28
4.2.20 Transaksionet me palët e lidhura.....	28
4.2.21 Aktivët dhe detyrimet e kushtëzuara.....	28
4.2.22 Krahasueshmëria e informacionit kontabel.....	29
5. Paraqitja me vlerë të drejtë.....	31
6. Aktivët afatgjata materiale.....	32
7. Aktive afatgjata jomateriale.....	33
8. Aktive Biologjike.....	33
9. Inventarë.....	33
10. Shpenzime të shtyra.....	34
11. Llogari të arkëtueshme tregtare.....	34
12. Llogari të arkëtueshme të tjera.....	35
13. Mjete monetare në arkë e në bankë.....	35
14. Kapitali.....	35
15. Primet e lidhura me kapitalin.....	36
16. Rezerva.....	36
17. Fitim/(Humbjet) e mbartura.....	37
18. Hua bankare.....	37
19. Provizione.....	38
20. Detyrime të tjera.....	38
21. Grante dhe të ardhura të shtyra.....	38
22. Llogari të pagueshme tregtare afatshkurtra.....	39
23. Llogari të pagueshme të tjera.....	39
24. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit.....	39
25. Puna e kryer nga njesia dhe që kapitalizohet.....	39
26. Të ardhura të tjera.....	40

27. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme.....	40
28. Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces.....	40
29. Shpenzime personeli.....	41
30. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit.....	41
31. Të ardhura dhe shpenzime interesi dhe të ngjashme.....	42
32. Tatimi mbi fitimin.....	43
33. Transaksionet me palët e lidhura.....	43
34. Ngjarje pas datës së raportimit financiar.....	43

Raporti i Audituesve të Pavarur

Për Drejtuesit dhe Aksionerin e ALBPETROL sh.a.

Opinion me Rezervë

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë Albpetrol sha (Shoqëria) të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 Dhjetor 2019, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital, pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin që mbyllet në këtë datë, shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, si dhe një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme kontabël.

Sipas opinionit tonë, me përjashtim të efekteve të çështjeve të përshkruara në "Bazat për Opinionin me rezerve", pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 Dhjetor 2019, dhe performancën e saj financiare dhe flukset e mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Bazat për Opinionin me Rezervë

1. Në shënimin 6 të pasqyrave financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2019, "Aktivet Afatgjata Materiale" paraqiten me vlerën 33,666,350 mijë lekë (2018: 34,864,090 mijë lekë). Shoqëria ka zgjedhur modelin e rivlerësimit për të matur vlerën e aktiveve afatgjata duke i paraqitur me vlerën e drejtë.

Në këtë grup, elementet troje dhe ndertesa nuk janë të mbështetura plotësisht në dokumenta pronësie. Për këtë arsye, vlera e tokës në shumën 8,361,235 mijë lekë nuk është reflektuar në kapitalin themelues por është mbajtur në një llogari të vecantë për të identifikuar këtë fakt. Për më tepër, ka raste ku sipërfaqet e paraqitura në kontabilitet janë të ndryshme me vertetimet hipotekore dhe me VKM nr. 219, date 16.04.2004 "Për miratimin e listes së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të cilat kalojnë në administrim të Albpetrol sha", si dhe ka raste të zaptimit të tokave dhe ndertesave apo edhe ndertime pa leje brenda sipërfaqeve të njesive. Gjithashtu, në grupin aktive afatgjata materiale, në vlerën 352,298 mijë lekë, përfshihet edhe vlera e banesave të ndertuara nga shoqëria, të cilat nuk zotërohen më por i kanë kaluar në pronësi Entit të Banesave.

Gjithashtu, në rastet kur shoqëria paraqet Aktivitet Afatgjata me vlerën e drejtë me modelin e rivlerësimit, për secilën kategori të rivlerësuar të aktiveve afatgjata materiale, ajo duhet të japë informacione në shënimet shpjeguese për vlerën kontabël (neto) që do të ishte njohur sikur aktivet të mateshin pas njohjes duke përdorur modelin e kosto. Keto të dhëna mungojnë në pasqyrat financiare të periudhës 2019.

2. Në shënimin 9 të pasqyrave financiare të mbyllura më 31 Dhjetor 2019 inventari paraqitet në vlerën 3,308,794 mijë lekë (2018: 2,589,560 mijë lekë). Për shkak se ne u emëruam si auditues në datën 24 Dhjetor 2019, ne nuk ishim të pranishëm në procesin e inventarizimeve vjetore të cilat shoqëria i ka realizuar në periudhën Tetor 2019. Me gjithë procedurat e tjera të zbatuara, për shkak edhe të natyrës së regjistrimeve të shoqërisë si edhe për shkak të mënyrës së ruajtjes së inventarëve,

AUDITUES LIGJORE				
Vullnetare Çela	Sokol Tozka	Luan Kamberi	Nexhmije Çela	Aida Maloku
Rr. Komuna e Parisit, Komp. Këa 2, Kulla 4, kt. 4, Tiranë	Rr. Tish Duhia, Komp. Këa 2, Kulla 2, Nr. 33, Tiranë	Rr. Emin Duraku, F. Avlacioni, Shk. 6, Ap. 66, Tiranë	Rr. Brigada 8, Pallati 8/1, Ap. 14, Tiranë	Laga Kastrioti, Rr. Brigada e 11 Sullmuese, Pallati nr. 58, Katë 2, Fier

ne nuk mundëm të siguroheshim nëpërmjet evidencës së duhur dhe të mjaftueshme në lidhje me sasisë e inventarit në datën 31 Dhjetor 2019.

a) Në pajtim me parashikimet në SNK 2 "Inventarët", kur inventarët dëmtohen, janë bërë tërësisht ose pjesërisht të vjetëruar ose nëse çmimet e shitjes së tyre kanë rënë, shoqëria duhet të kryejë zhvlerësimin e inventarëve poshtë kostos deri në vlerën neto të realizueshme.

b) Kështu, shoqëria trashëgon inventare të vjetër në vlerën 1,447,815 mijë Lekë dhe ka njohur zhvlerësime për inventarët vetëm në vlerën 137,487 mijë Lekë në perioda të mëparshme dhe nuk është kryer një test i vlerës së këtij inventari dhe llogaritja e zhvlerësimit të plotë në datën e pasqyrave financiare më 31 Dhjetor 2019.

c) Gjithashtu, shoqëria paraqet prodhimin e vet në zërin produkte të gatëshme, brenda zërit Inventarët, në vlerën 1,271,869 mijë Lekë (2018: 538,353 mijë lekë). Nëse sasia e prodhimit do të ishte paraqitur me cmimet e tregut të konstatuara në periudhën vijuese në të cilën do të realizohen shitjet e këtij prodhimi, ashtu sic pohoet edhe në shënimin 34, atëherë produkti i gatshëm do të kishte një vlerë jo më të madhe se 650,000 mijë lekë. Në këto rrethana, shoqëria duhet të kishte njohur një humbje prej rreth 621,000 mijë lekë.

Për këtë arsye, ne nuk mund të përcaktojmë efektet që mund të shkaktohen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse dhe pasqyrën e ndryshimit të kapitalit, si rrjedhojë e rregullimeve që mund të jene te nevojshme të kryhen për inventaret.

3. Në shënimin 12, "Llogari të arkëtueshme të tjera", pasqyra e pozicionit financiar, paraqitet në vlerën 3,588,920 mijë lekë (2018: 3,125,480 mijë lekë). Në këto vlerë përfshihen:

a) Të drejta ndaj të tretëve për kontrata hidrokarbure, në vlerën neto 2,640,630 mijë lekë më 31 dhjetor 2019 (2018: 2,296,145 mijë lekë). Këto vlera përfaqësojnë vlerën neto përkatëse të sasisë së produktit, që është llogaritur sipas parashikimeve të kontratave hidrokarbure, por që nuk është lëvruar fizikisht në depozitat e Albpetrolit. Këto vlera në tërësi nuk konfirmohen si detyrim nga ana e kontraktoreve, janë të kontestuara ose janë kundërshtuar në rrugë ligjore prej tyre. Shoqëria nuk ka krijuar provizione lidhur me këto fakte dhe ngjarje ekonomike.

b) Të drejta ndaj të tretëve për hua të dhëna me kontratë huaje sipas urdhërave të aksionarit në vlerën 614,765 mijë lekë më 31 dhjetor 2019 (2018: 446,070 mijë lekë). Për shkak se njesitë për të cilat janë dhënë huatë janë shoqëri të cilat i kanë pushuar aktivitetet, nuk shihen mundësi për arkëtimin e tyre dhe shoqëria nuk ka krijuar provizione lidhur me këto fakte dhe ngjarje ekonomike.

c) Aktive të tjera mbi një vit në vlerën 333,525 mijë lekë më 31 dhjetor 2019 dhe 383,265 mijë lekë në datën 31 dhjetor 2018. Ne nuk na u vunë në dispozicion informacione të mëtejshme lidhur me këto të drejta të arkëtueshme, për rrjedhojë, ne nuk ishim në gjendje të krijojmë siguri të arsyeshme për ekzistencën dhe vlerën e paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar të shoqërisë.

4. Në shënimin 11, "Llogari të arkëtueshme tregtare", në pasqyrën e pozicionit financiar, paraqitet shuma 17,382,762 mijë lekë më 31 dhjetor 2019 (2018: 16,931,641 mijë lekë). Për këto shuma ne nuk kemi mundur të arrijmë një siguri të mjaftueshme dhe të arsyeshme për saktësinë e tyre, as nëpërmjet procedurave të letrave të konfirmimit dhe as nëpërmjet kryerjes së procedurave alternative. Shoqëria nuk ka bërë teste zhvlerësimi dhe nuk ka llogaritur zhvlerësim për kërkesat e arkëtueshme, por ka paraqitur si zhvlerësim përgjithësisht llogaritë që janë me një vjetërsi mbi 5 vjet dhe që mundësitë e arketimit të këtyre llogarive janë konsideruar nga drejtimi si pa shprese. Për rrjedhojë ne nuk jemi në gjendje të vlerësojmë efektet që mund të rezultojnë nga korigjimet e mundshme të tyre, në pasqyrat financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2019 dhe 2018.

(Handwritten signatures)

AUDITUES LIGJORE

Vullnetare Çela Rr. Komuna e Parisit, Komp. Kika 2, Kulla 4, kt. 4, Tiranë	Sokol Toska Rr. Tish Dalia, Komp. Kika 2, Kulla 2, Nr.33, Tiranë	Luani Kamberi Rr. Emin Duraku, P. Aviacioni, Shk.A, Ap.66, Tiranë	Neshmije Çela Rr. Brigada 8, Pallati 8/1, Ap. 14, Tiranë	Aida Maloku Lagja Kastrioti, Rr. Brigada e 11 Sulmuese, Pallati nr. 58, Kati 2, Fier
--	--	---	--	--

5. Në shënimin 22 të pasqyrave financiare, gjendja e llogarive tregtare të pagueshme afatshkurtra paraqitet në vlerën 9,131,268 mijë lekë më 31 dhjetor 2019 (2018: 8,863,817 mijë lekë). Per keto shuma ne nuk kemi mundur të arrijmë një siguri të mjaftueshme dhe të arsyeshme për saktësinë e tyre, as nëpërmjet procedurave te letrave të konfirmimit dhe as nëpërmjet kryerjes së procedurave alternative. Për rrjedhojë ne nuk jemi në gjendje të vlerësojmë ndonjë efekt që mund të rezultonte nga ndonjë korigjim i mundshëm i tyre, në pasqyrat financiare te mbyllura më 31 dhjetor 2019 dhe 2018.

6. Në shënimin 10, në pasqyren e pozicionit financiar, paraqiten "Shpenzime të shtyra", në vlerën 43,238 mijë lekë më 31 dhjetor 2019 (2018: 40,000 mijë lekë). Në këto shpenzime, vlera prej 40,000 mijë lekë përfaqësojnë pagesa të kryera ndaj autoriteteve rregullatore dhe nuk pritet të kontribuojnë në realizimin e të ardhurave të tjera në periudhat e ardhëshme. Si rrjedhim, këto shpenzime duhet të ishin përfshirë në rezultatit e periudhës dhe të mos mbaheshin më tej në bilancin e gjendjes si aktive. Si pasojë e kësaj paraqitje aktive, rezultatit financiar dhe kapitalet e veta janë të mbivlerësuara për 40,000 mijë lekë më 31 dhjetor 2019.

7. Në shënimin 20, në pasqyren e pozicionit financiar, paraqiten "Detyrime të tjera", në vlerën 240,099 mijë lekë më 31 dhjetor 2019 dhe 2018. Këto balanca shfaqen si kundervlerë e AAM, të cilat nuk disponohen më nga shoqëria apo jane jashtë perdorimit. Ne keto rrethana shoqëria duhe te zbatoje kerkesat e SNK 16 duke njohur këto vlera në pakësim të aktiveve afatgjata materiale dhe jo si detyrime. Për rrjedhojë Aktivet Afatgjata Materiale dhe Detyrimet e tjera janë të mbivlerësuara për 240,099 mijë lekë më 31 dhjetor 2019 (2018: 240,099 mijë lekë).

8. Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit 12 "Tatimi mbi te ardhurat" kërkon që Shoqëria të njohë tatime të shtyra, për diferencat midis vlerës kontabël neto të aktiveve afatgjata materiale të rivlerësuara dhe bazës tatimore. Shoqëria nuk ka llogaritur tatimin e shtyrë. Për sa më sipër, ne nuk jemi në gjendje të vlerësojmë efektin që kjo përlllogaritje do të kishte në pasqyrat financiare të Shoqërise në 31 dhjetor 2019 dhe 2018.

9. Në shënimet për pasqyrat financiare Shoqëria nuk ka paraqitur shënimet për aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara në përputhje me SNK 37 si dhe shënimet për instrumentat financiare në përputhje me SNRF 7 së bashku me shënimet e menaxhimit të rrezikut.

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit të Përgjegjësive të Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare (të zbatueshme në juridiksionin përkatës) dhe kemi përmbushur edhe përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë me rezervë.

Vullnetare Çela
Rr. Komuna e Parisit, Komp. Kika 2, Kulla 4, kt. 4, Tiranë

Sokol Toska
Rr. Tish Dabria, Komp. Kika 2, Kulla 2, Nr. 33, Tiranë

AUDITUES LIGJORE
Luan Kamberi
Rr. Emin Duraku, P. Aviadomi, Shk.6, Ap.66, Tiranë

Nexhmije Çela
Rr. Brigada 8, Pallati B/1, Ap. 14, Tiranë

Aida Maloku
Lagja Kastrioti, Rr. Brigada e 12 Sulmuese, Pallati nr. 58, Katë 2, Fier

Informacione të tjera të Raportuara në Përputhje me Kuadrin Ligjor e Rregullator në Fuqi

Drejtimi ka përgjegjësinë për përgatitjen dhe raportimin e informacioneve të tjera. Informacionet e tjera, të cilat përfshijnë Raportin e Ecurisë së Veprimtarisë, Raportin Jofinanciar, Raportin e Drejtimit të Brendshëm dhe Raportin e Pagesave që u bëhen Institucioneve Shtetërore, përgatiten në zbatim të Ligjit 25/2018, "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe nuk përfshijnë pasqyrat financiare bashkëngjitur dhe as raportin tonë të auditimit mbi këto pasqyra.

Opinionin ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera të dhëna në raportet e mësipërme dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni i cili të japë siguri në lidhje me këto informacione.

Bazuar në përgjegjësinë tonë për të audituar pasqyrat financiare, ne kemi lexuar informacionet e tjera dhe kemi konstatuar se përmbajtja e këtyre informacioneve të dhëna në raportet e tjera të Shoqërisë, nuk bie në kundërshtim me pasqyrat financiare dhe as me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit të pasqyrave financiare. Në këtë kuptim ne nuk kemi asgjë për të raportuar në lidhje me informacionet e tjera.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e shoqërisë për të vazhduar aktivitetin në vijimësi, duke dhënë informacione shpjeguese për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuideojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart.

Organet e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport të audituesve që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe

AUDITUES LIGJORE				
Vullnetare Çela Rr. Komuna e Parisit, Komp. Kika 2, Kulla 4, kt. 4, Tiranë	Sokol Toska Rr. Tish Dajia, Komp. Kika 2, Kulla 2, Nr. 33, Tiranë	Luan Kamberi Rr. Emin Duraku, P. Avlacioni, Shk.6, Ap.66, Tiranë	Neshmije Çela Rr. Brigada 8, Pallati 8/1, Ap. 14, Tiranë	Aida Maloku Lagja Kastrioti, Rr. Brigada e 11 Sulmuese, Pallati nr. 58, Kati 2, Fier


marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.

- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
 - Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
 - Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të parimit të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
 - Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.
- Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Ne gjithashtu, ju japim personave të ngarkuar me qeverisjen një deklaratë që ne jemi në pajtim me kërkesat përkatëse etike në lidhje me pavarësinë, dhe ju komunikojmë atyre të gjitha lidhjet dhe çështjet e tjera që mundet në mënyrë të arsyeshme, të ndikojnë në pavarësinë tonë, dhe kur është e zbatueshme, masat mbrojtëse përkatëse.

11 Dhjetor 2020

AUDITUESIT LIGJORË

Vullnetare Çela	Sokol Toska	Luan Kamberi	Neshmije Çela	Aida Maloku
				
				

Pasqyra e Pozicionit Financiar

	Shënime	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
AKTIVE			
Aktivët afatgjatë			
Aktivët afatgjatë materiale	6	33,666,950	34,864,090
Aktivët afatgjatë jomateriale	7	109,262	134,283
Aktive biologjike	8	109	109
Totali i aktiveve afatgjatë		33,775,721	34,998,482
Aktivët afatshkurtra			
Inventarë	9	3,308,794	2,589,500
Sipenzime të shtyra	10	43,238	40,000
Llogari të arkëtueshme tregtare	11	17,382,762	16,931,641
Llogari të arkëtueshme të tjera	12	3,588,920	3,125,480
Mjetet monetare dhe ekuivalentët të tyre	13	635,218	1,475,142
Totali i aktiveve afatshkurtra		24,958,932	24,161,823
Totali i aktiveve		58,734,653	59,160,305
KAPITALI DHE DETYRIMET			
KAPITALI			
Kapitali themeltar	14	14,735,229	14,735,229
Prime të lidhura me kapitalin	15	8,361,235	0
Rezerva riheresimi	16	25,740,916	36,377,046
Rezerva ligjore	16	538,769	538,769
Rezerva të tjera	16	1,422,763	1,525,209
Firmë të mbartura	17	(5,302,979)	(6,959,602)
Firmi i ushtrimit		8,911	(19,973)
Totali i kapitalit		45,504,754	46,196,678
DETYRIMET			
Detyrime afatgjatë			
Hua afatgjatë	18	118,969	128,082
Provizione afatgjatë	19	194,589	80,000
Detyrime të tjera	20	240,099	240,099
Grante dhe të ardhura të shtyra	21	64,307	65,330
Totali i detyrimeve afatgjatë		617,964	513,511
Detyrime afatshkurtra			
Pjesa afatshkurter e huave afatgjatë	18	8,068	8,286
Llogari të pagueshme tregtare	22	9,131,268	8,863,817
Llogari të pagueshme të tjera	23	3,472,599	3,578,013
Totali i detyrimeve afatshkurtra		12,611,935	12,450,116
Totali i detyrimeve		13,229,899	12,963,627
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		58,734,653	59,160,305

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga drejtimi i shoqërisë më 4 Dhjetor 2020 dhe janë nënshkruar për publikim në emër të tyre nga:

Arian Lariçaj
DREJTOR I DREJTORISE SË FINANCES

Baftjar Zeqaj
ADMINISTRATOR

Pasqyra e Pozicionit Financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave Gjithpërfshirëse

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018
Të ardhura operative			
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	24	3,997,281	6,375,144
Puna e kryer nga njesia dhe që kapitalizohet	25	73,583	91,173
Të ardhura të tjera	26	118,179	44,042
Totali i të ardhurave operative		4,179,043	6,510,359
Shpenzime Operative			
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	27	(1,528,645)	(1,238,777)
Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimt në proces	28	1,181,772	(607,264)
Shpenzime personeli	29	(1,475,761)	(1,959,374)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	6,7	(590,537)	(620,846)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	30	(1,639,536)	(1,997,582)
Total shpenzime		(4,052,707)	(6,423,843)
Të ardhura/ Shpenzime financiare neto			
Të ardhura nga interes	31	2,248	324
Shpenzime interes dhe të ngjashme	31	(1,202)	(804)
Shpenzime të tjera financiare (neto)		-	9,836
Totali të ardhura/ Shpenzime financiare neto		1,046	9,356
Fitimi/humbja para tatimit		127,382	95,872
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	32	(118,471)	(115,845)
Fitimi/humbja e vitit		8,911	(19,973)
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		8,911	(19,973)

Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave Gjithpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

ALBPETROL sh.a.

Pasqyra Financiare më 31 Dhjetor 2019

(Te gjitha vlerat janë në mijë lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapitalin Neto

	Kapitali i nënshkruar	Pranti i lidhur me kapitalin	Rezerva Rrjedhësi	Rezerva Ligjore	Rezerva të tjera	Fundi i pashpërndarë	Fundi humbja e vitit	Totali
Më 1 janar 2018	14,701,929	(147,190)	43,062,377	538,769	909,719	(347,670)	(405,005)	58,312,929
Emetimi i kapitalit të nënshkruar	33,300					(5,550,253)	(405,005)	(5,192,958)
Zvogëlim i rezervës së rritjesimit		147,190	(8,885,332)			(856,674)	405,005	(856,674)
Transferim në fonde të rimbartura					615,400		(19,973)	595,427
Të tjera transferime akti kontrolli								
Ndryshime të kapitalit pas regjistruar								
Të ardhura të tjera gjëmpërfunduese për vitin	14,735,228	-	36,377,045	538,769	1,525,209	(6,959,802)	(19,973)	46,196,678
Më 31 dhjetor 2018	14,735,229	-	36,377,045	538,769	1,525,209	(6,959,802)	(19,973)	46,196,678
Më 1 janar 2019								
Emetimi i kapitalit të nënshkruar		8,361,235	(110,021,371)			1,060,136		(98,650,000)
Transferime brenda sektorit të kapitalit			(614,759)			(19,973)	19,973	(614,759)
Transferime jashtë sektorit të kapitalit						(102,536)		(102,536)
Transferim në fonde të rimbartura							8,911	8,911
Ndryshime të kapitalit pas regjistruar								
Të ardhura të tjera gjëmpërfunduese për vitin	14,735,229	8,361,235	26,740,916	538,769	1,422,673	(5,302,979)	8,911	45,604,764
Më 31 dhjetor 2019								

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapitalin Neto duhet të lexohet në bashkë me shtimin e shpjegues, të cilat janë pjesë përbërëse e kësaj përgjigjeje financiare.

Pasqyra e Flukseve të Mjeteve Monetare

Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitimi para tatimit	127,382	95,872
Rregullimet për shpenzimet jomonetare		
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	590,537	620,846
Shpenzime për vlerën neto të AAM	-	3,533
Shpenzime provizion ceshjesh gjyqesore	114,589	50,000
Shpenzime interesi	1,202	1,338
	833,710	771,587
Rregullime për ndryshimet në kapitalin punues:		
Rëniet(rritje) në të drejtat e arkivueshme dhe të tjera	(914,561)	1,465,516
Rëniet(rritje) në inventare	(719,234)	388,649
Rëniet(rritje) në shpenzime të shtyra	(3,238)	(40,000)
Rritjet(rënime) në detyrimet e pagueshme	267,451	60,125
Rritjet(rënime) në detyrime të pagueshme të tjera	(123,785)	332,164
Të ardhura të shtyra	(1,023)	(3,043)
	(660,680)	2,974,998
Tatimi mbi fitimin i paguar	(100,100)	195,738
Mjete monetare neto nga(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	(760,780)	3,171,736
Fluksi i Mjeteve Monetare nga(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(68,611)	(1,195,274)
Arkitime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	-	1,980
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata jomateriale	-	(97,442)
Arkitime nga shitja e investimeve të tjera	-	12
Mjete monetare neto nga(përdorur në) aktivitetin e investimit	(68,611)	(1,290,744)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Arkitime nga emetimi i kapitalit aksionar	-	33,300
Hua të paguara	(9,331)	(13,242)
Rezerva rivlerësimi dhe akt kontrolli ndryshim në Humbje të mbartura	-	(673,985)
Interesi i paguar	(1,202)	(1,338)
Mjete monetare neto nga(përdorur në) aktivitetin e financimit	(10,533)	(655,263)
Rritjet(rënime) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	(839,924)	1,225,729
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare në fillim të periudhës	1,475,142	249,413
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare në fund të periudhës	635,218	1,475,142

Pasqyra e Flukseve të Mjeteve Monetare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Shënimet Shpjeguese

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria Albpetrol sha (shoqëria) me NIPT J82916500U, është krijuar me vendim Nr 21158, datë 08.04.1999 të Gjykatës Tiranë, sipas regjistrimit tregtar, bazuar në ligjin Nr. 7638, datë 19 Nëntor 1992 "Mbi shoqëritë tregtare". Selia e shoqërisë është në adresën Patos, Fier.

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë kryerjen e operacioneve hidrokarbure në përputhje me Ligjin Nr 7746, datë 28.08.1993 për Kerkimin Zhvillim, Prodhimin, Trajtimin, Transportin, Magazinimin dhe Shitjen e naftës bruto, gazit dhe rërave bituminoze brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë si dhe çdo operacion tjetër tregtar apo shërbime që i shërbejnë aktivitetit të shoqërisë. Shoqëria brenda hapsirave të parashikuara nga legjilacioni në fuqi, do të kryejë çdo operacion projektues – preventivues, tregtar dhe financiar, që lidhet drejtpërdrejt ose terthorazi me objektin e saj. Kjo përfshin gjithashtu hapjen e veprimtarisë dhe krijimin e shoqërive të tjera brenda dhe jashtë vendit si dhe çdo aktivitet tjetër të mundshëm e të ligjshëm në përputhje me interesat e saj. Realizimi i objektit të veprimtarisë të shoqërisë, do të bëhet nepermjet shfrytëzimit dhe zhvillimit të zonave ekzistuese naftembajtëse dhe ato gazmbajtëse të vendit, kerkimeve të reja dhe zhvillimit të blloqeve në administrim si dhe shfrytëzimit të rërave bituminoze. Praktika atributet e ish APC-se Tiranë, që kanë të bëjnë me kerkim – prodhimin e hidrokarbureve i kalojnë shoqërisë Alpetrol sh.a duke filluar nga data 01.04.2003. Furnizimin me energji elektrike të klienteve të kualifikuar. Tregtimin e energjisë elektrike. Transmetimin e gazit natyror. Shpërndarja e gazit natyror. Leje mjedisore për veprimtari me ndikim në mjedis për vendburimet e naftës në zonat Kucove, Patos-Marinez (Drize +Goran), Ballsh Hekal, Amonice Gorisht, për vendburimet e gazit në zonen Divjak – Lushnje, Frakull-Fier, Povelc Fier, Finiq –Sarand, rrjeti i transmetimit të produkteve të naftës dhe të gazit., vendburimi i reres bituminoze Kasnic-Fier, Uzina Mekanike Kucove dhe Uzina Mekanike Patos.

Kapitali i nënshkruar i saj është 14,735,229,000 leke, i ndare në 14,735,229 aksione me vlerë nominale 1,000 leke secili. Kapitali i paguar është regjistruar në Leke.

Aksionet e Shoqërisë ALBPETROL Sh.a janë nën pronësinë e Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Drejtnesit e Shoqërisë janë si më poshtë:

- Këshilli Mbikëqyrës
- Administratori i Shoqërisë

Këshilli Mbikëqyrës i ALBPETROL sha në datë 31 dhjetor 2019 përbëhet si më poshtë:

1.	Evis	BERBERI	Kryetar
2.	Evis	MAMAJ	Anëtar
3.	Stefanaq	KOCOLLARI	Anëtar
4.	Laureta	OMERI	Anëtar
5.	Arta	GURABARDHI	Anëtar
6.	Illa	GJERMANI	Anëtar

Administratori i shoqërisë është Z. Baftjar ZEQAJ

Me vendim numër 5, datë 05/03/2019 të Këshillit Mbikëqyrës të Albpetrol sh.a., është liruar nga detyra e administratorit Z. Kastriot Bejtaj, dhe me vendim nr 6, datë 05/03/2019 të Këshillit Mbikëqyrës, është emëruar në detyrën e administratorit të Shoqërisë Albpetrol sh.a., Z. Dritan Spahiu.

Me vendim nr 22, datë 30/09/2019 të Këshillit Mbikëqyrës të Albpetrol sha është liruar nga detyra e administratorit Z.Dritan Spahiu, dhe me vendim nr 23, datë 30/09/2019 të Këshillit Mbikëqyrës, është emëruar në detyrën e administratorit Zj Eriola Muka.

Me vendim nr 4, datë 29/04/2020, të Këshillit Mbikëqyrës është liruar nga detyra e administratorit Zj.Eriola Muka dhe me vendim nr. 5, datë 29/04/2020 të Këshillit Mbikëqyrës është emëruar Z.Genti Gazheli në detyrën e administratorit të shoqërisë.

Me vendim nr 14, datë 28/09/2020 të Këshillit Mbikëqyrës të Albpetrol sha, është liruar nga detyra Z.Genti Gazheli dhe me vendim nr 15, datë 28/09/2020, është emëruar në detyrën e administratorit të shoqërisë Z.Baftjar Zeqaj

Veprimtaria e përditshme e shoqërisë drejtohet nga Administratori, të cilit, i përkasin të gjitha kompetencat për drejtimin ekzekutiv dhe përfaqëson shoqërinë në marrëdhëniet me të tretet.

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2019 është 1.768 punonjës (2018: 1.803 punonjës).

Shoqëria aktualisht e ushtron aktivitetin e saj nëpërmjet 11 Njësive Operative ose qendra, të cilat përgatisin secila Pasqyra Financiare më vete dhe nxjerrin rezultat të veçantë. Në qendër, shoqëria përgatit Pasqyra Financiare përmbledhëse të bilanceve kontabël të njësive të saj. Kontabiliteti në Qendër është i informatizuar, ndërsa në njësitë vartëse mbahet në mënyrë të përzier, manuale dhe të informatizuar.

2. Bazat e përgatitjes

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

2.2. Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNK") dhe interpretimet e nxjerra nga Komiteti për Interpretimet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("KIRFN") të BSNK-së.

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike, përveç aktiveve afatgjata materiale të cilat maten me vlerën e rivlerësuar.

2.3. Parimi i vijimësisë

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e parimit të vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek Shqiptar ("Lek"), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

Shumat janë paraqitur në "000" Leke përveç rasteve ku citohet ndryshe.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmeritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1 Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e klientëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të klientëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së klientëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2 Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatit e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.5.3 Zhvlerësimi i inventarëve

Shoqëria vlerëson gjendjen e inventarit në qarkullim të ulët dhe inventarin i cili ka humbur vlerën e përdorimit për shkak të zhvillimeve teknologjike apo arsyeve të tjera, me synim për të përcaktuar masën e zhvlerësimit të inventarit, bazuar në përdorimin e ardhshëm të tij dhe në llogaritjen e vlerës neto të realizueshme. Në rast se vlera neto e realizueshme e inventarit është më e ulët se vlera kontabël neto, ekziston një tregues që inventari është i zhvlerësuar. Shoqëria përdor gjykimin e saj për të përcaktuar masën e zhvlerësimit.

3. Standarde dhe interpretime të reja

Politikat e adoptuara të kontabilitetit janë në përputhje me ato të vitit të kaluar financiar.

Ndryshimet që rrjedhin nga përmirësimet në SNRF nuk kanë ndonjë ndikim në politikat kontabël, pozicionin financiar apo në ecurinë e Shoqërisë.

Një numër standardesh të reja, ndryshime në standarde dhe interpretime nuk janë ende efektive për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019, dhe nuk janë aplikuar më herët në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare.

3.1. Standardet e reja dhe të rishikuara të cilat janë në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019

- Ndryshimet në SNRF 16 "Qiratë" – SNRF 16 do të zëvendësojë SNK 17 dhe tre Interpretimet përkatëse. Qiratë do të regjistrohen në pasqyrën e pozicionit financiar në formën e një të drejte përdorimi të një aktivi dhe të një detyrimi qiraje. SNRF 16 hyn në fuqi në periudhat që fillojnë më ose pas 1 janar 2019. Drejtimi ka vlerësuar se Standardi nuk ka ndikim në Pasqyrat Financiare të Shoqërisë për Vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019.
- Ndryshimet në SNRF 9 "Instrumentet Financiare" - Karakteristikat e Parapagimit me Kompensim Negativ (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).
- Ndryshimet në SNK 19 "Përfitimet e punonjësve" - Ndryshimi i planit, shkurtimi ose shlyerja (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).
- Ndryshimet në SNK 28 "Investimet në Shoqëritë dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta" - Interesat Afatgjatë në Shoqëritë dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2019).

3.2. Standardet e reja, ndryshimet në standardet ekzistuese dhe interpretimet e reja të publikuara, por që ende nuk janë efektive

- SNRF 17 "Kontratat e Sigurimit" (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021),
- Ndryshimet në SNRF 3 "Kombinimet e Biznesit" - Përkufizimi i një Biznesi (efektiv për kombinime biznesi për të cilat data e blerjes është në ose pas fillimit të periudhës së parë vjetore të raportimit që fillon më ose pas 1 janarit 2020 dhe për blerjet e aktiveve që ndodhin në ose pas fillimit të asaj periudhe),
- SNRF 9 "Instrumentet Financiare", SNK 39 "Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja" dhe SNRF 7 "Instrumentet Financiare: Shënimet shpjeguese" - Reforma e Standardit të Normave të Interesit (efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 Janarit 2020),
- Ndryshime në SNRF 10 "Pasqyrat Financiare të Konsoliduara" dhe SNK 28 "Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta" - Shitja apo Kontributi i Aktiveve midis një Investitori dhe Ortakut të tij ose sipërmarrjes së përbashkët dhe ndryshimeve të mëtejshme (data efektive shtyhet për një kohë të pacaktuar deri kur projekti kërkimor mbi metodën e kapitalit është përfunduar),
- Ndryshimet në SNK 1 "Paraqitja e Pasqyrave Financiare" dhe SNK 8 "Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet" - Përkufizimi i Materialit (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2020).

4. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

4.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj këmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit këmbehen në monedhë funksionale me kursin e këmbimit të asaj date. Fitimi ose humbja nga kurset e këmbimit për zërat monetarë është diferenca midis kostos së amortizuar në monedhë funksionale në fillim të vitit dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj të këmbyerë me kursin e këmbimit në fund të vitit.

Aktivët dhe detyrimet jo-monetare të nominuara në monedhë të huaj të cilat maten me vlerë të drejtë këmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës në të cilën është përcaktuar vlera e drejtë. Zërat jo-monetarë në monedhë të huaj të cilat maten me kosto historike këmbehen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

Kurset e këmbimit zyrtare bankare të zbatuara sipas Bankës së Shqipërisë (Lekë kundrejt njësisë së monedhës së huaj) për monedhat kryesore më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 ishin si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
EUR/Lek	121.77	123.42
USD/ Lek	108.64	107.82

4.2. Instrumentat financiarë

4.2.1 Njohja dhe çregjistrimi

Aktivët dhe detyrimet financiare njihen kur Shoqëria bëhet palë e dispozitave kontraktuale të instrumentit financiar.

Aktivët financiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të flukseve të mjeteve monetare nga aktivi financiar, ose kur aktivët financiarë transferohen dhe në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet transferohen. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin.

Një detyrim financiar çregjistrohet kur shuhet, shkarkohet, anulohet ose skadon.

4.2.2 Klasifikimi dhe matja fillestare e aktiveve financiare

Përveç atyre të arkëtueshme tregtare që nuk përmbajnë një përbërës të konsiderueshëm financimi dhe maten me çmimin e transaksionit në përputhje me SNRF 15, të gjitha aktivët financiarë fillimisht maten me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit (aty ku është e aplikueshme).

Aktivët financiarë, të ndryshme nga ato të përcaktuara dhe efektive si instrumenta mbrojtës, klasifikohen në kategoritë e mëposhtme:

- Me kosto të amortizuar (AC)
- Me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (FVTPL)
- Me vlerë të drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (FVOCI).

Shoqëria aktualisht ka vetëm aktive financiare të klasifikuara me kosto të amortizuar

Klasifikimi përcaktohet nga:

- modeli i biznesit i njësisë ekonomike për menaxhimin e aktivit financiar
- karakteristikat e flukseve monetare kontraktuale të aktivit financiar.

Të ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me aktivet financiare që njihen në fitim ose humbje paraqiten brenda shpenzimeve financiare, të ardhurave financiare ose zërave të tjerë financiarë, me përjashtim të shpenzimeve zhvlerësimit të të arkëtueshmet tregtare të cilat përfshihen brenda shpenzimeve të tjera.

4.2.3 Matja e mëposhme e aktiveve financiare

Aktivitetet financiare maten me koston e amortizuar nëse plotësojnë kushtet e mëposhtme (dhe nuk janë paracaktuara si FVTPL):

- ato mbahen në kuadër të një modeli biznesi, qëllimi i të cilit është mbajtja e mjeteve financiare dhe mbledhja e flukseve monetare kontraktuale
- kushtet kontraktuale të aktiveve financiare krijojnë flukse të mjeteve monetare që janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit për shumën kryesore të papaguar

Pas njohjes fillestare, këto maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre, llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe llogaritë e arkëtueshme të tjera, që më parë ishin klasifikuar si të mbajtura deri në maturim sipas SNK 39, bëjnë pjesë në këtë kategori të instrumenteve financiare.

4.2.4 Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Kërkesat për zhvlerësim të SNRF 9 përdorin më shumë informacione të ardhshme për të njohur humbjet e pritshme të kreditit - 'modelin e humbjeve të pritshme të kreditit (ECL)'. Kjo zëvendëson SNK 39 'modelin e humbjeve të ndodhura'.

Instrumentet financiare në kuadër të kërkesave të reja përfshijnë kreditë dhe aktivet e tjera financiare të borxhit të matura me koston e amortizuar, llogaritë e arkëtueshme, aktivet financiare të matura me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse, aktivet e kontraktuara të njohura dhe të matur sipas SNRF 15 dhe angazhimeve të huasë dhe disa kontratave të garancisë financiare (për emetuesin) që nuk maten me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Njohja e humbjeve të kreditit nuk varet me prej identifikimit të një ngjarje individuale të humbjes së kredisë mbi baze individuale. Në vend të kësaj, Shoqëria konsideron një gamë më të gjerë informacioni gjatë vlerësimit të rrezikut të kredisë dhe matjen e humbjeve të pritshme të kreditit, duke përfshirë ngjarjet e kaluara, kushtet aktuale, parashikimet e arsyeshme dhe të mbështetura që ndikojnë në arkëtueshmërinë e pritshme të flukseve monetare të ardhshme të instrumentit.

Në zbatimin e kësaj qasjeje të ardhshme, bëhet një dallim midis:

- instrumentet financiare që nuk janë përkeqësuar dukshëm në cilësinë e kredisë që nga njohja fillestare ose që kanë rrezik të ulët të kredisë ('Faza 1') dhe
- instrumentet financiare që janë përkeqësuar dukshëm në cilësinë e kredisë që nga njohja fillestare dhe rreziku i kredisë i të cilit nuk është i ulët ('Faza 2').

'Faza 3' do të mbulonte aktivet financiare që kanë tregues objektive të zhvlerësimit në datën e raportimit.

Humbjet e pritshme të kreditit '12 - mujore' njihen për kategorinë e parë, ndërsa 'humbjet e pritshme të kreditit përgjatë jetës së instrumentit' njihen për kategorinë e dytë.

Matja e humbjeve të pritshme të kredisë përcaktohet nga një vlerësim i ponderuar me probabilitetin e humbjeve të kredisë gjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar.

Shoqëria nuk ka identifikuar dhe njohur zhvlerësim për aktivet financiare më 31 dhjetor 2019.

i) Zhvlerësimi i mëparshëm i aktiveve financiare sipas SNK 39

Në vitin paraprak, zhvlerësimi i aktiveve financiare është bazuar në modelin e humbjeve të ndodhura. Aktivet financiare individualisht të rëndësishme testoheshin për zhvlerësim kur kishin tregues për rënie në vlerë. Aktivi financiar, të cilat nuk ishin individualisht të rëndësishme rishikoheshin për zhvlerësim në grupe të përcaktuara në bazë karakteristikave të rrezikut të kreditit të përbashkët. Shoqëria nuk kishte identifikuar dhe njohur zhvlerësim për aktivet financiare deri më 31 dhjetor 2017.

ii) Klasifikimi dhe matja e detyrimeve financiare

Duke qenë se kontabilizimi i detyrimeve financiare mbetet kryesisht i njëjtë sipas SNRF 9 krahasuar me SNK 39, detyrimet financiare të Shoqërisë nuk janë ndikuar nga adoptimi i SNRF 9.

Detyrimet financiare fillimisht maten me vlerën e drejtë dhe, kur është e aplikueshme, përshtaten për kostot e transaksionit, përveç nëse Shoqëria ka përcaktuar një detyrim financiar me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Më pas, detyrimet financiare maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, përveç derivativave dhe detyrimeve financiare të përcaktuara në FVTPL, të cilat mbahen më pas me vlerën e drejtë me fitimet ose humbjet të njohura në fitim ose humbje (përveç instrumenteve financiare derivative të cilat janë të përcaktuara dhe efektive si instrumente mbrojtëse).

Të gjitha pagesat lidhur me interesin dhe, nëse është e zbatueshme, ndryshimet në vlerën e drejtë të një instrumenti që raportohen në fitim ose humbje përfshihen në kostot financiare ose të ardhurat financiare.

4.2.5 Instrumentet financiare derivative dhe kontabiliteti mbrojtës

Shoqëria zbaton kërkesat e reja të kontabilitetit mbrojtës në SNRF 9 prospektivisht. Të gjitha marrëdhëniet mbrojtëse që ishin marrëdhënie mbrojtëse sipas SNK 39 në datën e raportimit më 31 dhjetor 2018 plotësojnë kriteret e SNRF 9 për kontabilitetin mbrojtës më 1 janar 2019 dhe prandaj konsiderohen si marrëdhënie mbrojtëse të vazhdueshme.

Instrumentet financiare derivative llogariten me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes (FVTPL) me përjashtim të derivateve të përcaktuara si instrumente mbrojtës në marrëdhëniet

mbrojtëse të flukseve monetare, të cilat kërkojnë një trajtim të veçantë kontabël. Për t'u kualifikuar për kontabilitetin mbrojtës, marrëdhënia mbrojtëse duhet të plotësojë të gjitha kërkesat e mëposhtme:

- Ekziston një marrëdhënie ekonomike midis zërit të mbrojtur dhe instrumentit mbrojtës
- Efekti i rrezikut të kredisë nuk dominon ndryshimet e vlerës që rezultojnë nga ajo ekonomike
- Raporti i mbrojtjes i marrëdhënies mbrojtëse është i njëjtë me atë që rezulton nga sasia e elementit të mbrojtur që njësi ekonomike aktualisht mbron dhe sasia e instrumentit mbrojtës që njësi ekonomike aktualisht përdor për të mbrojtur atë sasi të elementit të mbrojtur.

Të gjitha instrumentet financiare derivative të përdorura për kontabilitetin mbrojtës njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe raportohen më pas me vlerën e drejtë në pasqyrën e pozicionit financiar.

Në masën që mbrojtja është efektive, ndryshimet në vlerën e drejtë të derivativëve të përcaktuar si instrumente mbrojtës në mbrojtjen e fluksit të mjeteve monetare njihen në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse dhe përfshihen në rezervën mbrojtëse të fluksit të mjeteve monetare në kapitalin neto. Çdo inefficence në marrëdhënien mbrojtëse njihet menjëherë në fitim ose humbje.

Në kohën kur elementi i mbrojtur ndikon në fitimin ose humbjen, çdo fitim ose humbje e njohur më parë në të ardhurat e tjera përmbledhëse riklasifikohet nga kapitali neto në fitim ose humbje dhe paraqitet si një riklasifikim brenda të ardhurave të tjera përmbledhëse. Megjithatë, nëse një aktiv ose detyrim jofinanciar është njohur si rezultat i transaksionit të mbrojtur, fitimet dhe humbjet e njohura më parë në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse përfshihen në matjen fillestare të elementit të mbrojtur.

Nëse një transaksion i ardhshëm nuk pritet të ndodhë, çdo fitim ose humbje e njohur në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse bartet menjëherë në fitim ose humbje. Nëse marrëdhënia mbrojtëse pushon të përmbushë kushtet e efektivitetit, kontabiliteti mbrojtës ndërpritet dhe fitimi ose humbja në fjalë mbahen në rezervën e kapitalit neto derisa të ndodhë transaksioni i ardhshëm.

Shoqëria nuk zotëron instrumenta financiare derivative më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018.

4.2.6 Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

4.2.7 Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se

shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

4.2.8 Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë.

4.2.9 Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuara duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlogaritur mbi bazën e interesit efektiv.

4.2.10 Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese.

Kostot e shndërrimit të inventarëve përfshijnë kostot e lidhura drejtpërdrejtë me njësitë e prodhimit, siç është puna e drejtpërdrejtë. Ato përfshijnë edhe një shpërndarje sistematike të shpenzimeve të përgjithshme të prodhimit fikse dhe variabël të cilat kryhen gjatë shndërrimit të materialeve në produkte të gatshme. Shpenzimet e përgjithshme të prodhimit fikse janë ato kosto jo të drejtpërdrejta të prodhimit të cilat mbeten relativisht të pandryshueshme pavarësisht vëllimit të prodhimit, si për shembull, amortizimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave dhe pajisjeve të fabrikës dhe kostot e drejtimit e të administrimit të fabrikës.

Shpenzimet e përgjithshme të prodhimit variabël janë ato kosto jo të drejtpërdrejta të prodhimit të cilat ndryshojnë në mënyrë të drekte, ose thuhet të drekte, me ndryshimin e vëllimit të prodhimit, si për shembull, materialet indirekte dhe puna indirekte.

Lendet e para	Me koston e blerjes dhe inventari i imët kosto blerje minus konsumin e llogaritur.
Prodhime në proces	Me kosto në baze të metodës së mesatares së ponderuar
Produkt i gatshëm	Me kosto të planifikuara.

4.2.11 Aktive afatgjata materiale

i) Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjata materiale, paraqiten me vlerën e rivlersuar, ne perputhje me rivleresimet e kryera gjate viteve.

Bazuar ne raportin e rivleresimit te Aktiveve dhe testin e zhvleresimit te shoqerise, sipas skemes kontabel qe rrjedh nga procesi i rivleresimit, u kryen veprimet kontabel sipas tabelave permbledhese per cdo qendër te shoqerise. Efektet financiare jane reflektuar ne llogaritë financiare qe prek ky proces per ushrimin e meparshem ne vitin 2018.

Kostot qe kanë te bëjnë me përmirësimet e mëpasshme i shtohen kostos së AAM-së vetëm nëse ato përmbushin kriteret e përkufizimit të AAM-ve dhe kriteret për njohjen e aktiveve në pasqyrën e pozicionit financiar. Kostot qe lidhen me mirëmbajtjet dhe riparimet e vazhdueshme njihen si shpenzime gjatë vitit ushtrimor.

Kostot përfshijnë shpenzime qe janë kryer drejtpërsëdrejti për blerjen e aktivitetit. Kostot e aktiveve te ndërtuara nga vete shoqëria, përfshijnë koston e materialeve dhe te fuqisë punëtore, si dhe ndonjë kosto tjetër qe lidhet direkt me vënien e aktivitetit ne kushte pune, si dhe kostot e çmontimit te zhvendosjes dhe te magazinimit te tyre ne vendndodhjen përkatëse. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Kur pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale kanë jetë të dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentë kryesor) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitja e një zëri të aktiveve afatgjata materiale vendosen duke krahasuar të ardhurat monetare nga shitja me vlerën e mbartur të aktiveve afatgjata materiale, dhe njihen neto brenda zërit "të ardhura të tjera" në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Kur aktivitetet e rivlerësuara shiten, sasitë e përfshira në rezervën së rivlerësimit transferohen në fitimin e mbajtur, ndërsa mungesa e rivlerësimit njihet ne pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimit te periudhës.

ii) Kosto të mëtejshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën e mbartur të elementit nëse është e mundshme që përfitime ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij elementi do të rrjedhin në Shoqëri dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve afatgjata materiale njihen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave në momentin kur ndodhin.

iii) Amortizimi

Amortizimi njihet në pasqyrën e të ardhurave e shpenzimeve me baze lineare për lidhjet teknologjike, pusët e naftes, tubacione e rezervuar, mbi bazën e jetës se dobishme të vlerësuar të çdo pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale dhe me metodën zbritëse për ndertesat, makineritë dhe pajisjet, mjetet e transportit, pajisjet e zyrës dhe kompjuterike, dhe aktivitetet

e tjera me një normë amortizimi siç shpjegohet më poshtë. Toka dhe punimet në proces nuk amortizohen.

AAM janë njohur në kontabilitet me koston e blerjes së tyre dhe shoqëria ka zgjedhur si politike të saj kontabël modelin e koston ku çdo element i AAM paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar. Shoqëria nuk ka akumuluar as një humbje nga zhvlerësimi. Deri në vitin 2017, normat e amortizimit të zbatuara ishin ato të përcaktuara në vendimin nr.24, dt.30/04/2007 të Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë. Për periudhën ushtrimore të vitit 2018 dhe 2019, shoqëria aplikoi norma të reja të amortizimit të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës me vendim nr. 4, date 11/04/2018, në përputhje me normat fiskale të përcaktuara në ligjin nr.8438,dt.28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat".

Norma e amortizimit vjetor është si më poshtë:

	2019	2018
Bazë lineare		
Lidhjet teknologjike, pusët, tubacione	1.5%	1.5%
Metoda zbritëse		
Makinat dhe pajisje	20%	20%
Pajisje informatike e të tjera	25%	25%
Ndërtesa	5%	5%

iv) Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

4.2.12 Aktive afatgjata jomateriale

i) Njohja dhe matja

Licencat, të drejtat e përdorimit të cilat përfitohen nga Shoqëria paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi, nëse ka.

ii) Shpenzimet e mëpasshme

Shpenzimet e mëpasshme kapitalizohen vetëm në rastin kur shojnë përfitimet e ardhshme ekonomike për aktivin specifik me të cilat ato lidhen. Të gjitha shpenzimet njihen si fitim/humbje kur ndodhin.

iii) Amortizimi

Amortizimi njihet në pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse duke përdorur metoden lineare mbi jetëgjatësinë e parashikuar të aktiveve jomateriale që nga data që janë të disponueshme për përdorim.

4.2.13 Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri.

Të ardhurat nga shitja e naftës dhe gazit janë matur me vlerën e drejtë të pagesave të arkëtuara ose të arkëtueshme, pakësuar me tatimet dhe taksat mbi shitjet dhe mbi fitimin (akcizat, taksat e rrugës, dhe të tjera të ngjashme). Të ardhurat nga shitja e mallrave janë matur me vlerën e drejte të pagesave të arkëtuara ose për tu arkëtuar, pakësuar me tatimet dhe taksat mbi shitjet. Të ardhurat nga shitja janë vlerësuar me vlerën e drejte të kompesimit të marre, neto nga kthimet, uljet tregtare, uljet mbi volumet dhe rabatat. E ardhura është njohur kur rreziket dhe të drejtat mbi produktet i kalojnë në një pjesë të rëndësishme blesorit, marrja e kompesimit është e mundshme, kostot e lidhura dhe kthimet e mundshme të mallrave mund të maten me besueshmëri dhe nuk ka më përfshirje të vazhdueshme të drejtimit të Shoqërisë me këto produkte.

4.2.14 Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

4.2.15 Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

Shpenzimet e lindura nga qiratë operative njihen në pasqyrën e të ardhurave në bazë të metodës lineare sipas kohëzgjatjes së qirasë.

Shoqëria ka qira operative.

4.2.16 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

4.2.17 Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2019 është 15% (2018: 15%).

Tatimi i shtyre llogaritet duke përdorur metodën e bilancit kontabël, duke sjelle diferenca të përkohshme midis vlerës kontabël të aktiveve dhe pasiveve për raportin financiar dhe vlerës kontabël për qëllime tatimi. Diferencat e përkohshme nuk parashikohen për njohjen fillestare të aktiveve dhe pasive që nuk kanë asnjë ndikim mbi kontabilitetin apo fitimin e tatueshem. Shuma e tatimit të shtyre bazohet në mënyrën e pritshme të realizimit apo shlyerjes së shumës së akumuluar të aktiveve dhe pasiveve, duke përdorur normat tatimore në fuqi në datën e bilancit.

Një aktiv i detyrimit të shtyre njihet vetëm nëse ka të ngjarë që fitimet e ardhshme të tatueshme do të jenë në dispozicion, e ndaj të cilave aktiv i mund të përdoret. Aktivet e tatimit të shtyre reduktohen deri në shkallën ku nuk është më e mundur që të realizohet përfitimi përkatës nga tatimi.

4.2.18 Përfitimet e punonjësve

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

4.2.19 Provizionet

Provizionet njihen kur Shoqëria ka një detyrim aktual (ligjor ose të tërthortë) si rezultat i një ngjarjeje në të kaluarën dhe ka mundësi që do të nevojitet një fluks burimesh që përfshin përfitimet

ekonomike për te përmbushur detyrimin dhe në këtë mënyrë mund të bëhet një përlogaritje e besueshme e shumës së detyrimit. Në rast se efekti është material, provizionet janë përcaktuar duke skontuar flukset e pritshme të parasë me normën e uljes para tatimeve, e cila reflekton vlerën kohore të parasë në kushtet aktuale të tregut dhe, aty ku është e përshtatshme, normën e riskut të pasiveve specifike. Provizionet rishikohen në çdo datë bilanci dhe nëse nuk ka më mundësi për nevojën e një fluksi burimesh që përfshin përfitimet ekonomike për shlyerjen e detyrimit, provizionet kthehen. Provizionet përdoren vetëm për qëllimin që janë njohur fillimisht. Ato nuk njihen për humbjet e ardhshme operative. Aktivët e kushtëzuara nuk njihen.

4.2.20 Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

4.2.21 Aktivët dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4.2.22 Krahasueshmeria e informacionit kontabël

Kur është e nevojshme, shifrat krahasuese axhustohen (tregullohen) konform me ndryshimet në paraqitje në periudhën aktuale raportuese. Riklasifikimet kryhen për të paraqitur më mirë natyrën e biznesit të Shoqërisë. Ato aplikohen retrospektivisht.

Shoqëria ka bërë disa riparaqitje në bilanci në gjendjes të vitit paraardhës 2018 dhe këto paraqiten në diagramen në vijim.

ALBPETROL sh.a.

Pasqyrat Financiare më 31 Dhjetor 2019

(Të gjitha vlerat janë në mijë lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2018 bëhet	31 dhjetor 2018 ishte	Diferenca
AKTIVE				
Aktivet afatgjata		34,864,090	34,864,090	
Aktivet afatgjata materiale		134,283	134,283	
Aktivet afatgjata jomateriale		109	109	
Aktive biologjike		34,998,482	34,998,482	
Totali i aktiveve afatgjata				
Aktivet afatshkurtra		2,589,560	2,589,560	
Inventarë		40,000	40,000	
Shpenzime të shtyra		16,931,641	15,948,387	983,254
Llogari të arkëtueshme tregtare	11	3,125,480	3,493,244	-367,764
Llogari të arkëtueshme të tjera	12, 16	1,475,142	1,475,142	
Mjetet monetare dhe ekuivalente të tyre		24,161,823	23,546,333	615,490
Totali i aktiveve afatshkurtra		59,160,305	58,544,815	615,490
Totali i aktiveve				
KAPITALI DHE DETYRIMET				
KAPITALI				
Kapitali themelues		14,735,229	14,735,229	
Prime të lidhura me kapitalin		0	0	
Rezerva rihvlerësimi		36,377,046	36,377,046	
Rezerva ligjore		538,769	538,769	
Rezerva të tjera	16	1,525,209	909,719	615,490
Fidime të mbartura		-6,959,602	-6,959,602	
Fidimi i ushtrimit		-19,973	-19,973	
Totali i kapitalit		46,196,678	45,581,188	615,490
DETYRIMET				
Detyrime afatgjata		128,082	128,082	
Hua afatgjata		80,000	80,000	
Provizione afatgjata		240,099	240,099	
Detyrime të tjera		65,330	65,330	
Grante dhe të ardhura të shtyra		513,511	513,511	
Totali i detyrimeve afatgjata				
Detyrime afatshkurtra		8,286	8,286	
Pjesa afatshkurtrë e huasë afatgjatë		8,863,817	8,863,817	
Llogari të pagueshme tregtare		3,578,013	3,578,013	
Llogari të pagueshme të tjera		12,450,116	12,450,116	
Totali i detyrimeve afatshkurtra		12,963,627	12,963,627	
Totali i detyrimeve		59,160,305	58,544,815	615,490
Totali i kapitalit dhe detyrimeve				

5. Paraqitja me vlerë të drejtë

Një numër politikash kontabël dhe shënimesh shpjeguese të shoqërisë kërkojnë matje sipas vlerës së drejtë për aktivet dhe detyrimet financiare dhe jo-financiare. Vlera e drejtë e instrumenteve financiarë që nuk shiten në një treg aktiv përcaktohet nga teknikat e vlerësimit. Shoqëria përdor

ALBPETROL sh.a.

Pasqyrat Financiare më 31 Dhjetor 2019

(Të gjitha vlerat janë në mijë lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

grykimin për të zgjedhur një numër të ndryshëm metodash dhe bën supozime të cilat bazohen kryesisht në kushtet aktuale të tregut në çdo përlogaritje apo datë raportimi.

Vlerësimet e vlerave të drejta janë bazuar në paraqitjen e pozicionit financiar të instrumenteve ekzistuese financiare pa u përpjekur për të vlerësuar vlerën e biznesit të pritshëm dhe vlerën e aktiveve dhe pasiveve që nuk konsiderohen instrumenta financiarë.

	Me vlerën e drejtë përmes fitimit dhe humjes	Me vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	Me kosto të amortizuar	Totali i vlerës kontabil	Vlera e drejtë
31 dhjetor 2019					
Mjetet monetare dhe ekuivalente të tyre	-	-	635,217	635,217	635,217
Llogari të arkëtueshme tregtare	-	-	17,382,762	17,382,762	17,382,762
Llogari të arkëtueshme të tjera	-	-	3,588,920	3,588,920	3,588,920
Llogari të pagueshme tregtare	-	-	9,131,268	9,131,268	9,131,268
Të tjera të pagueshme	-	-	3,472,600	3,472,600	3,472,600
Hua afatgjata	-	-	127,037	127,037	127,037

	Me vlerën e drejtë përmes fitimit dhe humjes	Me vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	Me kosto të amortizuar	Totali i vlerës kontabil	Vlera e drejtë
31 dhjetor 2018					
Mjetet monetare dhe ekuivalente të tyre	-	-	1,475,142	1,475,142	1,475,142
Llogari të arkëtueshme tregtare	-	-	16,931,641	16,931,641	16,931,641
Llogari të arkëtueshme të tjera	-	-	3,125,480	3,125,480	3,125,480
Llogari të pagueshme tregtare	-	-	8,863,817	8,863,817	8,863,817
Të tjera të pagueshme	-	-	3,578,013	3,578,013	3,578,013
Hua afatgjata	-	-	136,368	136,368	136,368

ALBPETROL sh.a.

Pasqyrat Financiare më 31 Dhjetor 2019

(Të gjitha sferat janë në mijë lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

6. Aktivet afatgjata materiale

Aktivet afatgjata materiale përbëhen si më poshtë:

	Toka	Kalëtrues	Makinari dhe instalime	Pajisje informetike	Ta tjera në shfrytëzim	Total
Kosto						53,565,962
Gjendja më 1 janar 2018	14,816,539	2,309,294	35,542,195	123,014	774,799	1,195,279
Shtesa	221,971	34,569	452,764	31,366	474,684	(3,753)
Paketime	-	(10)	(3,189)	(259)	(245)	-
Riklasifikime realla grupave	-	(202,810)	129,600	5,248	150,962	-
Shtesa nga rihedhjet / AAM	743,920	962,909	5,221,794	2,044	203,444	2,794,072
Paketime nga rihedhjet / AAM	(7,294,381)	(966,714)	(12,355,865)	(39,475)	(620,620)	(21,291,655)
Gjendja më 31 dhjetor 2018	8,486,149	1,977,122	24,961,532	121,990	991,165	36,238,358
Shtesa	-	5,304	119,546	22,885	51,349	197,994
Paketime	(504,280)	(110,963)	(1,95,352)	-	(91,353)	(861,953)
Riklasifikime realla grupave	-	-	27,317	(3,461)	-	1,933
Shtesa nga rihedhjet / AAM	31,903	11,099	103,114	-	-	134,039
Paketime nga rihedhjet / AAM	-	(2,823)	-	-	-	(2,823)
Gjendja më 31 dhjetor 2019	7,992,763	1,869,310	25,073,960	142,969	997,571	35,568,573
Amortizimi / akumuluar						(7,207,804)
Gjendja më 1 janar 2018	-	(941,262)	(6,512,459)	(32,733)	(121,057)	(8,007,511)
Amortizimi / përshfritje	-	(51,879)	(596,860)	(24,381)	-	(1,133,120)
Paketime	-	136	10,111	51	-	14
Riklasifikime realla grupave	-	1,967	4,108	(3,537)	(3,659)	(986,133)
Shtesa nga rihedhjet / AAM	-	(2,370)	(463,714)	(25)	-	(468,809)
Paketime nga rihedhjet / AAM	-	475,262	6,257,407	34,875	123,216	6,945,760
Gjendja më 31 dhjetor 2018	-	(118,073)	(1,211,294)	(23,894)	(1,301)	(1,355,478)
Amortizimi / përshfritje	-	(82,844)	(592,401)	(22,204)	-	(697,449)
Paketime	-	4,209	1,511	-	(6,022,429)	-
Riklasifikime realla grupave	-	(141,985)	4,168,614	(5,202)	-	(5,291)
Shtesa nga rihedhjet / AAM	-	-	-	-	-	-
Paketime nga rihedhjet / AAM	-	-	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2019	-	(361,412)	4,454,249	(51,147)	(6,022,938)	(1,922,251)
Vlera neto korrigjimit						34,646,322
Gjendja më 31 dhjetor 2018	8,486,149	1,558,049	23,749,328	87,993	961,663	33,844,209
Gjendja më 31 dhjetor 2019	7,992,763	1,278,897	26,578,225	91,822	(5,126,267)	33,866,250

ALBPETROL sh.a.**Pasqyrat Financiare më 31 Dhjetor 2019***(Të gjitha vlerat janë në mijë lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)*

Ne zbatim të Urdhërit të Ministrisë të Zhvillimit Ekonomik, Tregëtisë dhe Sipermarrjes nr.1461, dt 20/02/2015, është kryer rivlerësimi i Aktiveve Afatgjata Materiale për shoqërinë Albpetrol sh.a.

Ne datë 31/03/2018, shoqëria paraqiti pranë Keshillit Mbikqytës relacionin për rivlerësimin e aktiveve afatgjata materiale, bazuar në raportin përfundimtar të eksperteve vlerësues të dorëzuar pranë shoqërisë Albpetrol sh.a. Ky rivlerësim është kryer në zbatim të Standarteve Nderkombëtare të kontabilitetit nr 16, dhe nr 36, lidhur me vlerësimin e "Aktiveve Afatgjata Materiale".

Vlerësimi i AAM u krye për gjendjen kontabel të AAM sipas pasqyrave financiare të dt 31/12/2014, nëpërmjet matjes së tyre pas njohjes faktike dhe në faktin që shoqëria Albpetrol nuk kishte kryer testin e zhvlerësimit që nga rivlerësimi i fundit i AAM të vitit 2005.

Më vendim të Keshillit Mbikqytës nr 15, datë 29/08/2018, u miratua raporti i eksperteve vlerësues, me qëllim realizimin e ndryshimeve në kapitalin e shoqërisë dhe pasqyrimin e efekteve financiare të procesit të rivlerësimit në pasqyrat financiare të vitit 2018.

Në zbatim të vendimit të Keshillit Mbikqytës nr 15, datë 29/08/2018, shoqëria Albpetrol sh.a paraqiti në pasqyrat financiare të vitit 2018, efektet financiare të këtij procesi.

Më 31 dhjetor 2019 Albpetrol sh.a, nuk i ka të regjistruara të gjitha pronat në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme. Shoqëria është në duke vazhduar procesin për regjistrimin e pasurive të paluajtshme.

7. Aktive afatgjata jomateriale

Aktive afatgjata jomateriale më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 detajohen si më poshtë:

	Software	Total
Me kosto		
Gjendja më 1 janar 2018	58,990	58,990
Shtesa	97,441	97,441
Gjendja më 31 dhjetor 2018	156,431	156,431
Shtesa	-	-
Riklasifikim midis grupeve	(1,831)	(1,831)
Gjendja më 31 dhjetor 2019	154,600	154,600
Amortizimi		
Gjendja më 1 janar 2018	(14,168)	(14,168)
Amortizimi i vitit	(7,980)	(7,980)
Gjendja më 31 dhjetor 2018	(22,148)	(22,148)
Amortizimi i vitit	(23,190)	(23,190)
Gjendja më 31 dhjetor 2019	(45,338)	(45,338)
Gjendja më 31 dhjetor 2018	134,283	134,283
Gjendja më 31 dhjetor 2019	109,262	109,262

8. Aktive Biologjike

Aktivitet biologjike më 31 dhjetor 2019 në vlerën 108,700 lekë (2018: 108,700 lekë) përfaqësojnë aktivitet drufrutor të Qendrës Mekanike Kuçovë.

9. Inventarë

Në këtë zë janë përfshirë materialet ndihmëse dhe lënda djegëse, balanca e së cilave më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme		479,353
a-Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme	467,043	(137,487)
b-Zhvierësimi i materialeve	(137,487)	
	329,556	341,866
Prodhime në proces dhe gjysmiprodukte	38,038	53,869
Produkte të gatshme	1,271,869	538,353
Maltra	1,669,331	1,665,472
Totali	3,308,794	2,978,209

Lëvizjet në zhvierësimin e inventarit:

	2019	2018
Gjendja më 1 janar	137,487	137,487
Rimarrje për vitin	-	-
Zhvierësimi për vitin	-	-
Gjendja më 31 dhjetor	137,487	137,487

10. Shpenzime të shtyra

Shpenzime të shtyra paraqet veprimin në zbatim të urdherit nr 862, datë 13/12/2018 "Mbi miratimin e shpërndarjes së të ardhurave që përfitohen nga marreveshja hidrokarbure" të miratuar nga Ministri i Infrastruktura dhe Energjise.

Në bazë të këtij vendimi, drejtimi i shoqërisë nxori urdher nr 142, datë 21/12/2018 me nr.12649 prot. datë 21/12/2018, për transferimin e shumes prej 40,000 mijë leke nga shoqëria Albpetroli sh.a te Agjencia Kombetare e Burimeve Natyrore Tirane.

	2019	2018
Parapagim AKBN	40,000	40,000
Parapagim INSIG për sigurimin e mjeteve	3,238	0
Gjendja më 31 dhjetor	43,238	40,000

11. Llogari të arkëtueshme tregtare

Balanca e llogarive të arkëtueshme tregtare të shoqërisë më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqitet si më poshte:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Llogari të arkëtueshme		
Deri 1 vit	723,094	617,134
Mbi 1 vit	17,220,639	16,875,478
	17,943,733	17,492,612
Zhvlërimi i kërkesave të arkëtueshme	(560,971)	(560,971)
Totali	17,382,762	16,931,641

Lëvizjet në zhvlërimin e të drejtave për arkëtim:

	2019	2018
Gjendja më 1 janar	560,971	1,544,225
Sistemim	-	(983,255)
Zhvlërimi për vitin	-	-
Gjendja më 31 dhjetor	560,971	560,971

12. Llogari të arkëtueshme të tjera

Llogaritë e tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 detajohen si më poshte:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Akiza	74,836	74,836
Te drejta ndaj sigurimeve shoqërore mbi 1 vit	-	52,119
Te drejta nga kontraktoret neto	2,740,630	2,296,145
Hua të dhëna	666,468	446,070
Aktive të tjera	1,241,943	1,239,564
Deri 1 vit	130,892	10,246
Mbi 1 vit	1,111,051	1,229,318
	(1,134,957)	(983,254)
Totali	3,588,920	3,125,480

Lëvizjet në zhvlërimin e të drejtave për arkëtim:

	2019	2018
Gjendja më 1 janar	983,254	-
Sistemim	-	983,254
Provizione për kontraktoret HK	100,000	-
Provizione për huatë e dhëna	51,703	-
Gjendja më 31 dhjetor	1,134,957	983,254

ALBPETROL sh.a.

Pasqyrat Financiare më 31 Dhjetor 2019

(Te gjitha vlerat janë në mijë lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

Posti "Te drejta ndaj sigurimeve shoqerore" në vlerën 52,119 mijë lekë (viti 2018), është i mbartur nga bashkime që shoqëria Albpetrol sha ka kryer ndër vite dhe nuk paqyron një te drejte reale. Për këtë arsye, u kalua në rezultat në periudhën 2019.

Në aktive të tjera, shuma 2,740,630 mijë lekë, paraqet te drejtat e shoqërisë, që rrjedhin nga detyrimet kontraktuale të të tjerëve konform parashikimit të termave të kontratave hidrokarbure, të lidhura midis Shoqërisë Albpetrol sha dhe kontraktoreve, që duhet të ishin marrë në dorezim, por që nuk janë levruar fizikisht në depozitat e Shoqërisë Albpetrol sha.

Hua të dbena paraqet transferime fondesh të kryera nga Albpetrol sha, në favor të kompanive të tjera publike nëpërmjet kontratave të huave.

Në zbatim të Urdhërave të Ministrit të Infrastrukturas dhe Energjisë si dhe marrëveshjeve dypaleshe të shoqërisë me AKBN dhe AlbgaZ sha, vlera e huave është rritur në shumën rreth 220 milion lekë.

13. Mjete monetare në arkë e në bankë

Balanca e mjeteve monetare më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Banka	635,167	1,474,892
Arka	51	250
Totali	635,218	1,475,142

14. Kapitali

Kapitali i shoqërisë më 31 dhjetor 2019 është 14,735,229 mijë lekë (2018: 14,735,229 mijë lekë) i zotëruar 100% nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë.

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Niveli aksioneve	14,735,229	14,735,229
Vlera nominale (në lekë)	1,000	1,000
Totali (në mijë lekë)	14,735,229	14,735,229

15. Primet e lidhura me kapitalin

Primet e lidhura me kapitalin më 31 dhjetor 2019 paraqiten në vlerën 8,361,235 lekë (2018: 0 lekë), kjo vlerë përfaqëson koston historike të tokës për të cilin nuk disponohet një dokument hipotekor dhe për këtë arsye nuk janë përfshirë në kapitalin ligjor por janë paraqitur si prime.

ALBPETROL sh.a.**Pasqyrat Financiare më 31 Dhjetor 2019***(Të gjitha vlerat janë në mijë lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)***16. Rezerva**

Rezerva rivlerësimi më 31 dhjetor 2019 në vlerën 25,740,916 mijë lekë (2018: 36,377,045 mijë lekë). Zvogelimi i llogarise Rezerva Rivlerësimi paraqitet si me poshte:

	2019	2018
Gjendja më 1 janar	36,377,045	43,062,377
Sistemin me logarise Prime të lidhura me kapitalin për vlerën historike të tokës	(8,361,235)	-
Zvogelimi të tjera	(7,505)	-
Zvogelimi i kapitalit për vlerën e pasurive pjesë përberese të "Baza Tubove Zhupari"	(570,954)	-
Zvogelim kapitali për vlerën aseteve transferuar shoqërisë "Albgaz" sh.a.	(36,249)	-
Sistemin me logarise "Fitim dhe humbje të mbartura"	(1,660,136)	-
Sistemin rezerva nga rivlerësimi dhe primet e kapitalit	-	(6,685,331)
Gjendja më 31 dhjetor	25,740,916	36,377,046

Rezerva ligjore më 31 dhjetor 2019 paraqitet në shumën 538,769 mijë lekë (2018: 538,769 mijë lekë).

Rezerva të tjera më 31 dhjetor 2019 paraqiten në shumën 1,422,673 mijë lekë (2018: 1,525,209 mijë lekë).

	2019	2018
Gjendja më 1 janar	1,525,209	909,719
Zmadhim kapitali përshirje asete të nenkontraktoreve	-	615,490
Zvogelimi i kapitalit për vlerën e pasurive pjesë përberese të "Baza Tubove Zhupari"	(92,732)	-
Zvogelim kapitali për vlerën aseteve transferuar shoqërisë "Albgaz" sh.a.	(9,804)	-
Gjendja më 31 dhjetor	1,422,673	1,525,209

17. Fitim/(Humbjet) e mbartura

Fitim/(Humbjet) e mbartura më 31 dhjetor 2019 janë vlerën (5,302,979) mijë lekë (2018: (6,959,602) mijë lekë), zmadhuar me 1,656,623 mijë leke.

Zmadhimi i fitimit të pashpërndarë më 31 dhjetor 2019 paraqitet si më poshtë:

	2019	2018
Gjendja më 1 janar	(6,959,602)	(347,670)
Efektet e vopimeve të zvogelimit të kapitalit për asetet kalkule Albgazit	11,284	-
Rillogarita e konsumit të inventarit të imet për vitet 2015, 2016, 2017 QAKP	10,377	-
Efekte të rivlerësimit të AAM	-	(5,979,992)
Efekte tatimore	-	(656,673)
Sistemin për diferencën e amortizimit të log mbi bazën e vlerës së rivlerësuar të aktivitetit dhe amortizimit të logarituar në fakt për vitet 2015, 2016 dhe 2017.	(5,204)	429,738
Sistemin me diferencën rivlerësimi	1,660,136	-
Rezultati vit paraardhës	(10,973)	(405,005)
Gjendja më 31 dhjetor	(5,302,979)	(6,959,602)

18. Hua bankare

Huatë afatgjata me 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
E pagueshme deri në 1 vit	8,068	8,286
E pagueshme mbi 1 vit	118,969	128,082
Totali	127,037	136,368

Ndermjet Qeverise se Republikes se Shqiperise dhe Institutit Qendror per Kreditin Afatmesem SPA, eshte lidhur Marreveshja Financiare per Programin e Mbeshtetjes se Bilancit te Pagesave me vlere 22 miliard lireta (Projekti COMM 98-FROT/AID-98/001/00) konvertuar në euro, e administruar nga Banka Kombetare Tregtare për Albpetrol sh.a. dhe ish Servcom sh.a. Kjo hua paraqitet në dy nga njesite e Albpetrol ne Qendren e Furnizimit te Materialeve dhe ne Qendren e Sherbimeve Gjeofizike Patos (ish Servcom).

Gjate vitit 2019, eshte likuiduar principal dhe interesa sipas dokumentit bankar paraqitur nga marreveshja midis Albpetrol sha dhe ish Servcom sha me BKT dega Tirane. Efektet e ketyre veprimeve jane paraqitur ne pozicionet financiare perkatese ne pasqyrat financiare te vitit 2019.

E shprehur ne monedhen Euro, detyrimi ne total per kredine italiane (afatshkurter&afatgjata) eshte 1,043,251 Euro, nga te cilat 503,551 Euro eshte detyrimi ndaj Ministrise se Financave dhe Ekonomise, per likuidimet qe kjo Ministri ka kryer per shoqerine Albpetrol sha.

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Banka Kombetare Tregtare	65,719	74,220
Ministria Financave dhe Ekonomise	61,317	62,148
Totali	127,037	136,368

19. Provizione

Provizionet më 31 dhjetor 2019 në shumën 194,589 mijë lekë (2018: 80,000 mijë lekë) perfaqesojnë vlerën e provizioneve per rrezique te ndryshme. Ne vitin 2019, u krijuan provizione per çështje gjyqësore në proces, në vlerën 114,589 mijë lekë.

Nga vlera e mbartur prej 80.000 mijë leke, vlera prej 50.000 mijë leke perfaqeson provizione per çështje gjyqësore në proces dhe vlera prej 30,000 mijë leke e mbartur, nuk eshte llogaritur nga shoqeria Albpetrol sha, por rezulton nga bashkimi me perthithje i Uzines Mekanike Patos dhe Transnafta Patos me Shoqerine Albpetrol sha, respektivisht 15,000 mijë lekë Uzina Mekanike Patos (QSHGJ) si dhe 15,000 mijë lekë Transnafta Patos (QT Patos).

20. Detyrime të tjera

Detyrime të tjera më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Kundërparti AAM pa përfshirë në kapital	140,753	140,753
Kundërparti për asetet pa vlerë përdorimi	337	337
Kundërparti për asetet e Nj.Z.I. në privatizim	99,009	99,009
Totali	240,099	240,099

Shuma 140,753 mijë lekë paraqet fondin Kundërparti AAM për asetet e Nj.Z.I (në privatizim), në momentin e bashkimit të Albpetrol me Uzinat Mekanike. (Raporti i zmadhimit të kapitalit të Albpetrol sha që vjen nga bashkimi me përthithje të shoqërisë Albpetrol sha të Uzines Mekanike Patos dhe Uzines Mekanike të Naftes Kucove).

Shuma 337 mijë lekë paraqet fondin k/parti për asetet pa vlerë përdorimi të QMN Kucove (Uzina Mekanike Naftes Kucove), të trashëguar nga momenti i shpërbërjes nga Shoqëria Servcom sha.

Shuma 99,009 mijë lekë paraqet vlerën e aktiveve në Transnafta Patos, që nuk gjenerojnë të ardhura. Mospërfshirja në shumën e zmadhimit të kapitalit të vlerës së këtyre asetëve, është motivuar nga fakti se këto aktive nuk do të shërbejnë aktivitetit të ardhshëm të kompanisë. Baza ligjore e këtij veprimi është VKM nr.784, dt.15/09/2006 pika 6 (raporti i zmadhimit të kapitalit të Albpetrol sha që vjen nga bashkimi me përthithje të shoqërisë Albpetrol sha, Servcom sha Fier dhe Transnafta Patos).

21. Grante dhe të ardhura të shtyra

Grante dhe të ardhura të shtyra më 31 dhjetor 2019 në vlerën 64,307 mijë lekë (2018: 65,330 mijë lekë) paraqet grantet e përfituara nga shoqëria për aktive afatgjata materiale. Grantet janë njohur në të ardhura në mënyrë sistematike gjatë periudhës kontabel. Paksimi neto i tyre për vitin 2019 në shumën 1,023 mijë lekë (2018: 3,043 mijë lekë) pasqyrohet në Pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve siç detajohet në shënimin "Të ardhura të tjera".

22. Llogari të pagueshme tregtare afatshkurtra

Llogari të pagueshme tregtare afatshkurtra më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Furnitore të papaguar	9,078,942	8,812,250
Debitore kreditorë të tjerë	52,326	51,567
Totali	9,131,268	8,863,817

23. Llogari të pagueshme të tjera

Llogari te pagueshme të tjera afatshkurtra më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Paga personale	0	101,040
Detyrim sigurime shpëtorore dhe shëndetsore	23,477	18,904
Tatim Fitimi	190,307	171,896
TVSh për tu paguar	5,876	17,002
Tatimi mbi te ardhurat	7,227	5,479
Tatim në burim	1,165	4,573
Renta minerare	9,451	20,448
Tatime të tjera	0	3,535
Tatime të tjera	352,129	352,129
Gjoha dhe interesat të fletësitura	2,882,967	2,882,967
Dividende për t'u paguar	3,472,599	3,578,013
Totali		

24. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 detajohen si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018
Nga shitja e naftës	2,634,401	5,369,333
Nga shitja e gazit	13,514	10,576
Nga shitja e energjisë	1,332,178	970,881
Shtesime të tjera	7,188	24,354
Totali	3,987,281	6,375,144

25. Puna e kryer nga njesia dhe që kapitalizohet

Puna kryer nga njesia dhe e kapitalizuar për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqiten si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018
Puna e kryer nga njesia dhe që kapitalizohet	73,583	91,173
Totali	73,583	91,173

26. Të ardhura të tjera

Të ardhurat e tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqiten si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018
Qera e zakonshme	4,854	3,200
Shitje skrap	49,190	-
Konsum vetjak	234	10,286
Tëprica inventari	978	464
Shitje shtesë	1,783	12,295
Gjyba, penalitete	13,934	8,166
Arkivim debitorësh	-	30
Të ardhura të tjera	46,183	2,773
Të ardhura nga bonuset	-	3,785
Të ardhura nga grantet	1,023	3,043
Totali	118,179	44,042

27. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 në vlerën 1,528,645 mijë lekë (2018: 1,238,777 mijë lekë) paraqet shpenzimet që kryen për blerjen e karburantit, të energjisë elektrike, si dhe materiale të tjera të konsumueshme, që i nevojiten procesit të prodhimit.

28. Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces

Ndryshimi i gjendjes së produktit të gatshëm dhe prodhimit në proces për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqitet si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018
Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces	1,181,772	(607,264)
Totali	1,181,772	(607,264)

ALBPETROL sh.a.

Pasqyrat Financiare më 31 Dhjetor 2019

(Të gjitha vlerat janë në mijë lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

Gjendja e produktit të gatshëm dhe në proces me:

	2019	2018
Gjendja më 1 janar	582,222	997,592
Gjendja më 31 dhjetor	1,309,907	582,222
Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces	727,685	(415,370)
Firo ligjore	-	9,748
Gjendje pranë nënkontraktoreve pa dorëzuar	444,486	(201,641)
Te tjera produkt i palevizshëm	9,601	
Diferenca	1,181,772	(807,264)

29. Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 detajohen si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018
Shpenzime për paga	(1,305,061)	(1,757,431)
Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	(170,700)	(201,943)
Totali	(1,475,761)	(1,959,374)

Shpenzimet e personelit perbehen nga pagat, dhe kontributet e sigurimeve shoqerore e shendetesore. Numri mesatar vjetor i punonjesve per vitin 2019 eshte 1,775 punonjes dhe per vitin 2018 ishte 2,167 punonjes.

30. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 detajohen si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018
Renta minerare	(264,813)	(536,913)
Gjoha dhe dëmshperblime	(157,227)	(536,853)
Takse dhe tarifa vendore	(205,012)	(192,900)
Shpenzime arbitrazhi	(124,008)	(113,278)
Shpenzime transporti per materiale	(54,566)	(85,946)
Vlera kontabel neto e AAM-ve	(98,364)	(3,533)
Shpenzime auditim bilanc dhe te tjera	(76,875)	(50,359)
Shpenzime ruajtje objekti	(61,168)	(64,440)

41/44

ALBPETROL sh.a.

Pasqyrat Financiare më 31 Dhjetor 2019

(Të gjitha vlerat janë në mijë lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

Sistemim tërimesh	(133,812)	(60,000)
Provizione	(266,291)	(50,000)
Punime e shërbime nga të tjerë	(20,515)	(36,323)
Sigurim jete dhe pasurie	(13,750)	(32,723)
Kontroll pasje konformiteti	(18,711)	(11,383)
Sigurim magazina fiskale	(12,590)	(14,414)
Konsum vetjak	(234)	(10,287)
Blerje të pastokueshme (solar,vaj kompresori)	(14,918)	(28,908)
Shpenzime për objekt dhe mjete me qera	(4,005)	(10,444)
Transferime, udhetime e dieta	(9,740)	(7,235)
Regjistrim pasurie	(21)	(2,911)
Taksa aktpadi	(916)	(577)
Firo	-	(9,748)
Shpenzime transporti për personelin	(23,542)	(26,209)
Te tjera	(11,726)	(11,097)
Subvencione të dhëna	(960)	(3,888)
Shpenzime monitorim mjedisi	(9885)	(12,382)
Taksa e regjistrimit	(5,425)	(7,306)
Personel jashtë njesise	(2,448)	(3,537)
Siguracion automjetesh	(5,235)	(3,561)
Publicitet, reklama	(948)	(1,338)
Ndihma ekonomike	(6,835)	(6,853)
Shpenzime për pritje e përfaqësime	(3,758)	(3,255)
Shpenzime postare e telekom.	(3,728)	(3,767)
Shpenzime të tjera	(17,811)	(2,882)
Kërkime dhe studime	(2,440)	(7,551)
Trajtime të përgjithshme (energji,uje)	(1,034)	(1,009)
Mirëmbajtje, riparime	(945)	(41,054)
Shpenzime për leje Mjedimore	(1,184)	(1,315)
Shpenzime për shërbimet bankare	(655)	(777)
Shpenzime kalërim rez nafte	(760)	(37)
Kancelari	(97)	(394)
Inventar i imet jashtë përdorimit	(403)	(194)
Totali	(1,639,538)	(1,997,582)

31. Të ardhura dhe shpenzime interesi dhe të ngjashme

Të ardhura dhe shpenzime interesi dhe të ngjashme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 detajohen si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018
Të ardhura nga interesat	1,058	324
Shpenzime interesi dhe të ngjashme	-	(904)
Të ardhura nga konvertimi	1,190	10,367
Shpenzime nga konvertimi	(1,202)	(532)
Totali	1,046	9,356

32. Tatimi mbi fitimin

Përlogaritja e tatimit mbi fitimin për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Fitimi para tatimit	127,382	95,872
Shpenzime të pajtohura	662,425	676,427
Fitimi tatimor i ushtrimit	789,807	772,299
Tatimi mbi fitimin (15%)	(118,471)	(115,845)
Fitimi i periudhës	8,911	(10,973)

33. Transaksionet me palët e lidhura

Palë e lidhur konsiderohet një entitet që ka aftësinë të kontrollojë apo të ushtrojë një influencë të konsiderueshme mbi palën tjetër në marrjen e vendimeve financiare dhe operacionale, apo palët janë nën kontroll të përbashkët me Shoqërinë. Një numer i caktuar transaksionesh me palë të lidhura janë ndërmarrë gjatë aktivitetit operacional të shoqërisë. Këto transaksione janë bërë sipas afateve dhe normave të tregut.

Volumi i këtyre transaksioneve dhe balancat në fund të periudhave respektive janë si vijojnë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Detyrime		
Ministria Financave dhe Ekonomisë	2,882,967	2,882,967
Totali	2,882,967	2,882,967

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018
Shpenzime		
Shpenzime për shpërblimet e Keshillit drejtimi	140	1,537
Shpenzime për shpërblimin e administratorit	265	2,597

34. Ngjarje pas datës së raportimit financiar

Që nga 31 dhjetori 2019, përhapja e COVID-19 ka patur ndikim të rëndësishëm në shumë ekonomi lokale në mbarë globin. Në shumë vende, bizneset po detyrohen të ndërpresin ose kufizojnë operacionet për periudha të gjata ose të pacaktuara kohore. Masat e marra për të ngadalësuar përhapjen e virusit, të cilat përfshijnë ndalimet e udhëtimit, karantinat, distancimin shoqëror dhe

mbylljen e shërbimeve jo thelbësore, kanë shkaktuar ndërprerje të konsiderueshme për bizneset në të gjithë botën, duke rezultuar në një ngadalësim ekonomik. Tregjet globale të aksioneve kanë provuar gjithashtu një paqëndrueshmëri të madhe dhe një dobësim të ndjeshëm. Qeveritë dhe bankat qendrore janë përgjigjur me ndërhyrje monetare dhe fiskale për të stabilizuar kushtet ekonomike. Edhe Qeveria e Shqipërisë ka marrë një sërë masash në kuadër të ngadalësimit të përhapjes së virusit të cilat përfshinë shtyrjen e kësteve të kredive për tre muaj për bizneset dhe individët të cilët kanë patur vështirësi ekonomike për shkak të masave të marra për ngadalësimin e përhapjes së virusit, shtyrjen e pagesave të qirave për tre muaj, si dhe një sërë masash për ndalimin e bizneseve që konsiderohen jo thelbësore dhe me rrezik për përhapjen e sëmundjes dhe kufizimin e lëvizjes së lirë të njerezve brenda fashave orare të përcaktuara.

Si pasojë e pandemisë, në mënyrë të vecantë, u vërejt një rënie e fortë e cmimeve të produktit naftë bruto në tregjet botërore. Kjo do të ndikojë në mënyrë të drejtpërdrejtë në vlerën e shitjes së produktit të gatshëm që shoqëria dispononte në datën e këtyre pasqyrave financiare. Shoqëria nuk bëri rregullime për këtë ngjarje.

Shoqëria ka përcaktuar që këto ngjarje janë ngjarje pas datës së bilancit të cilat nuk kërkojnë korigjime. Prandaj, pozicioni financiar dhe rezultatet e operacioneve më dhe për vitin që mbyllet më 31 dhjetor 2019 nuk janë korigjuar për të pasqyruar ndikimin e tyre. Kohëzgjatja dhe ndikimi i pandemisë COVID-19, si dhe efektiviteti i përgjigjeve të qeverisë dhe bankës qendrore, mbetet i paqartë në këtë kohë. Nuk është e mundur të vlerësohet me besueshmëri kohëzgjatja dhe ashpërsia e këtyre pasojave, si dhe ndikimi i tyre në pozicionin financiar dhe rezultatet e Shoqërisë për periudhat e ardhshme. Drejtimi pret që provigjioni i llogarive të arkëtueshme dhe të ardhurat dhe shpenzimet nga aktiviteti kryesor të ndikohen nga kjo situatë. Ndikimi do të njihet në pasqyrat financiare të Shoqërisë më 2020.

Nuk ka ngjarje të rëndësishme të cilat do të kërkonin korigjim të pasqyrave financiare të ndodhura midis datës së raportimit 31 dhjetor 2019 dhe datës së autorizimit të këtyre pasqyrave financiare.